



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PRESIDENTI

AUTORIZIM

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 149/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 9, të nenit 221, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të Vendimit nr. 469, datë 21.11.2022, "Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit nga Presidenti i Republikës, për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2023", si dhe Vendimit nr. 404, datë 25.11.2019, "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi"",

AUTORIZOJ:

1. Kryerjen e drejtimit dhe moderimit të procedurës së hedhjes së shortit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në datën 5.12.2022, ora 10:00 dhe shpalljen e rezultatit nga zoti **Alket Jaupi**, Këshilltar i Presidentit të Republikës.
2. Tërheqjen rastësore të goglave për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga anëtarë të Sekretariatit Teknik dhe/ose nga përfaqësues të institucioneve apo misioneve të ekspertizës së huaj, të cilët janë ftuar për të qenë të pranishëm në procedurën e hedhjes së shortit, përkatësisht sipas ftesës së drejtuesit e moderuesit të procedurës.
3. Zotin Jaupi, të ndjekë rregullat për organizimin e procedurës së hedhjes së shortit, të përcaktuara në Vendimin nr. 404, datë 25.11.2019, "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi".

